


RINIA DHE BASHKËPUNIMI RINOR, GUR THEMELI I POLITIKAVE ZHVILLIMORE TË BASHKISË TIRANË

Në dokumentin e saj strategjik për politikat zhvillimore Bashkia Tiranë të rinjtë janë në qendër të prioritetëve bazuar në parimin që investimi tek të rinjtë është një investim në të ardhmen e qytetit. Aktivizimi dhe angazhimi i rinisë në fusha të ndryshme shoqërore, kulturore, edukative dhe ekonomike është kthyer në një gur themeli për zhvillimin e qëndrueshëm të Tiranës, një politikë që ka marrë një shtysë të veçantë që nga shpallja e Tiranës si Kryeqyteti Evropian i Rinisë në vitin 2022.

Që nga viti 2022, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë iniciativash që synojnë të mbështesin, fuqizojnë dhe integrojnë të rinjtë në jetën publike dhe ekonomike të qytetit. Aktivitetet që kanë filluar si pjesë e programit të Kryeqytetit Evropian të Rinisë janë kthyer në traditë, duke u zhvilluar çdo vit për të promovuar kreativitetin, inovacionin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve. Ndër aktivitetet kryesore për të rinjtë mund të përmendim: Tirana Art Festival, një konkurs që zbulon dhe promovon talentet rinore në fushën e artit. Shif e Bej Filma, një platformë për të rinjtë që krijojnë filma me metrazh të shkurtër. FOLEJa, një projekt që përfshin të rinjtë në rivitalizimin e hapësirave publike. Kampi i vullnetarëve, një kamp socializimi për rrjetin e vullnetarëve pranë Bashkisë së Tiranës.

Këto iniciativa jo vetëm që krijojnë hapësira për argëtim dhe kreativitet, por gjithashtu synojnë të formojnë liderët e ardhshëm, duke i inkurajuar të rinjtë të marrin përgjegjësi dhe të angazhohen në proceset vendimmarrëse.



Një nga aspektet më të rëndësishme të politikave të Bashkisë së Tiranës është modernizimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për të rinjtë. Deri në vitin 2026, Bashkia synon të ndërtojë tre qendra rinore të reja dhe të rijetëzojë ish-shtëpitë e pionerit si qendra rinore multifunktionale. Këto iniciativa synojnë të krijojnë hapësira ku të rinjtë mund të marrin pjesë në aktivitete edukative, kulturore dhe sportive, duke zhvilluar aftësitë e tyre dhe krijuar një bazë për integrimin e mëtejshëm social dhe ekonomik. Për më tepër, Bashkia po ndërton një infrastrukturë rinore në zonat rurale, duke siguruar që edhe të rinjtë jashtë qendrës së Tiranës të kenë qasje në mundësitë që ofrohen për zhvillim dhe aktivizim.

Një aspekt kyç i politikave rinore të Bashkisë së Tiranës është përfshirja e të rinjve në vendimmarrje dhe krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim. Në dokumentin e politikave zhvillimore të përcaktuar deri në vitin 2027, Bashkia synon të angazhojë të paktën 1,000 të rinj në proceset e vendimmarrjes vendore dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre aktive në aktivitete vullnetare. Këshilli Vendor Rinor, një detyrim që rrjedh nga ligji i miratuar rishtazi “Për Rininë” është një nismë që synon të fuqizojë të rinjtë dhe t’i inkurajojë ata të kontribuojnë në zhvillimin e qytetit përmes diskutimeve dhe debateve konstruktive.

Për më tepër, Bashkia po mbështet fuqishëm punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve përmes skemave mbështetëse me grante për sipërmarrjet rinore, veçanërisht ato të gjelbra, dhe kreditë e buta për bizneset e reja. Sipas përcaktimit në dokumentin zhvillimor synohet që deri në vitin 2027, të paktën 1,000 të rinj të jenë të punësuar në projekte të ndryshme zhvillimore.

Politikat zhvillimore të Bashkisë së Tiranës, me fokusin e saj në rininë dhe bashkëpunimin rinor, përfaqësojnë një model të qartë të angazhimit për të ndërtuar një qytet të qëndrueshëm dhe inovativ.

